



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 771, Datë 11.02.2021

“Për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, i ndryshuar”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.02.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore”, i ndryshuar.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore”, i ndryshuar,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 707, datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore për periudhën kohore nga 1 janar 2019 deri në 30 nëntor 2020. Raporti i hetimit paraprak duhej të paraqitej në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Për realizimin e proceduarve hetimore është kërkuar informacion nga ndërmarrjet që veprojnë në tregun e prodhimit të barnave në vend si dhe ndërmarrjet që importojnë dhe tregtojnë pajisje mjekësore, informacion i cili ende nuk është depozituar.
3. Koha e mbetur në dispozicion, dhe mungesa e informacionit të kërkuar është e pamjaftueshme

për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 707, datë 23.09.2020, i ndryshuar.

4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraparak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 707, datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraparak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore”, pika 3 e tij të ndryshohet si vijon:

“3. Raporti i hetimit duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 31 mars 2021”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS